

KOMISIONI I POSACËM I APELIMIT TË
IMIGRACIONIT

Nr. i apelimit: SC/191/2022
Datat e seancave dëgjimore: 19, 20, 21 dhe 22 mars 2024
Data e gjykimit: 17 qershor 2024

Përpara

TË NDERUAR Z. JUSTICE CHAMBERLAIN
GJYQTARE E TRIBUNALIT TË SIPËRM
OWENS
ZOTI ROGER GOLLAND

Ndërmjet

SALI BERISHËS

Ankimuesi

dhe

SEKRETARIT TË SHETIT
PËR DEPARTAMENTIN E MINISTRISË SË
BRENSHME (HOME DEPARTMENT)

I padituri

GJYKIM I HAPUR

FERGUS RANDOLPH KC (udhëzuar nga **Zaiwalla dhe Co.**) u paraqit në emër të Ankimuesit

LISA GIOVANNETTI KC dhe **WILL HAYS** (udhëzuar nga Departamenti Ligjor i Qeverisë) u paraqitën në emër të Sekretarit të Shtetit

ASHLEY UNDERWOOD KC dhe **ADAM STRAW KC** (udhëzuar nga Zyra e Suportit të Avokatëve të Posaçëm) u paraqitën si Avokatë të Posaçëm

Hyrje

- 1 Dr Sali Berisha është një shtetas shqiptar. Ai u diplomua dhe ushtroi detyrën e mjekut, duke u specializuar në kardiologji, dhe duke u nderuar në një shkallë më të lartë në këtë fushë. Nga viti 1992 e deri në vitin 1997, ai ishte presidenti i parë jo komunist në Shqipëri. Nga viti 1997 deri në vitin 2005, ai ishte kryetar i opozitës në Kuvendin e Shqipërisë. Nga viti 2005 deri në vitin 2013, ai ishte Kryeministër, më pas deputet dhe duke filluar nga maji 2022 Kryetar i Partisë Demokratike. Ai është aktualisht Kryetari i opozitës në Kuvendin e Shqipërisë.
- 2 Më 21 korrik 2022, Sekretari i Shtetit për Departamentin e Ministrisë së Brendshme (“SSHD”) i dërgoi një letër me shkrim Dr Berishës duke e informuar se më datë 19 korrik 2022 ishte marrë vendimi për të mos lejuar hyrjen e tij në Mbretërinë e Bashkuar për shkak të përfshirjes së tij në çështje kriminale dhe korrupsion. Në të u tha se prania e tij në MB nuk ishte e favorshme për të mirën publike. Arsyet ishin si më poshtë:

“.. ju keni lidhje të qarta me grupe dhe kriminelë të krimit të organizuar që paraqesin një kërcënim për sigurinë publike në Shqipëri dhe në MB dhe se jeni i gatshëm për t’i përdorur këto lidhje për të çuar përpara ambiciet tuaja politike, dhe...keni përdorur pozitat tuaja zgjedhore për t’u përfshirë në korrupsion dhe sjellje kriminale për të pasuruar veten dhe rrethin tuaj të ngushtë, në veçanti këshilltarin tuaj të zgjedhjeve të mëparshme Damir Fazliç, të cilin më pas e mbrojtët kur ndaj tij dolën prova inkriminuese.”
- 3 Tashmë dihet se vendimi për përjashtimin e Dr. Berishës ishte një nga një sërë vendimesh të marra përsa i përket shtetasve shqiptarë si pjesë e Projektit Crime State Nexus (“CSNP”), i cili ka si qëllim ndërprerjen e lidhjeve midis politikanëve dhe krimit të organizuar në Ballkanin Perëndimor dhe Shqipërinë në veçanti.
- 4 Më datë 18 gusht 2022, Dr. Berisha depozitoi një kërkesë për shqyrtim në SIAC, në bazë të s. 2C i Aktit të 1997-tës të Apelimeve të Posaçme të Imigracionit (“Akti i vitit 1997”). Më pas, SSHD pranoi të rimarrë në konsideratë vendimin, mbi bazën e disa materialeve mbi të cilën vendimi ishte mbështetur dhe të ftonte përfaqësimet për këto materiale. Gjatë kësaj kohe, kërkesa drejtuar SIAC u pezullua. Dr Berisha shfrytëzoi rastin për të bërë përfaqësimet, të cilat u morën parasysht. Më 27 shkurt 2023, SSHD i dërgoi email avokatëve të Dr Berishës për t’i informuar se SSHD kishte vendosur ta mbante në fuqi këtë vendim.
- 5 Është e kuptueshme që ne duhet ta trajtojmë këtë vendim të dytë si vendim operativ për qëllime të kësaj kërkesë për shqyrtim sipas s. 2C i Aktit të 1997-ës. Megjithatë, ne vëmë re se mbrojtja e parashtruar nga Fergus Randolph KC për Dr Berishën në vendimin e parë, dhe ajo çka ai thotë se materiali mbi të cilin ky vendim është marrë është një pjesë e vogël e materialit të dorëzuar, mbetet një pjesë e rëndësishme e historikut kundrejt të cilit ligjshmëria e vendimit të dytë mbetet të jetë gjykuar.

Bazat e ankimit

- 6 Bazat e Ndryshuara të Kërkesës për Shqyrtim (“Bazat e ndryshuara”) u depozituan më 9 tetor 2023. Ato ishin:
 - (a) **Gabim ligjor:** Siç mund të vihet re nga deklaratat dëshmuese të Dr Berishës dhe vajzës së tij Argita Malltezi dhe materialit të përvetësuar për to, Dr Berisha nuk ka “lidhje të qarta me grupe të krimit të organizuar dhe grupe kriminale” dhe nuk “ i ka përdorur postet e tij zgjedhore për tu angazhuar në korrupsion dhe sjellje kriminale për të pasuruar

[veten] dhe rrethin [e tij] të ngushtë”. Kështu, SSHD ka vepruar në mënyrë të paligjshme duke bërë gjetje të cilat janë të pambështetura në prova dhe/ose të bazuara në pikëpamje që nuk kanë baza të arsyeshme për të qëndruar, duke pasur parasysh në veçanti: (i) mungesën e provave të drejtpërdrejta, duke demonstruar shkelje në lidhje me shitblerjen e tokës tek Damir Fazlliç; (ii) mungesën e provave që tregojnë një lidhje personale midis Dr. Berishës dhe Fation Dautit; (iii) pranimin se komunikimet diplomatike ndërmjet Ambasadës së Madhërisë së Tij në Tiranë dhe FCDO-s në Londër humbën; (iv) ndryshimin e qëndrimit të tij midis vendimit të parë (ku thuhej se filmimi i një partie që po mësynte selinë e Partisë Demokratike “shfaqte” Dr Berishën si organizator dhe pjesëmarrës në një protestë të dhunshme në të cilën përfshiheshin edhe disa kriminelë të njohur) dhe vendimit të dytë (ku thuhej se ky ishte një veprim “i pretenduar/dyshuar”); (v) pranimin e SSHD-së se Dr Berisha kërkonte të luftonte korrupsionin; (vi) faktin se, siç është pranuar tanimë, akuzat për korrupsion që përfshijnë vajzën e Dr. Berishës (përveç transaksioneve me z. Fazlliç) nuk ishin një aspekt kyç i rekomandimit në vitin 2022; dhe (vii) pranimin e SSHD-së se burimet mbi të cilat u bazuan nuk ofrojnë prova konkrete për lidhjet e dyshuara (**Arsyetimi 1**).

- (b) **Irracionalitet:** Vendimi për të hetuar Dr Berishën dhe për të ndërmarrë një drejtim përjashtimor kundrejt tij ishte irracional sepse kjo solli një dallim arbitrar midis Dr. Berishës dhe personave të tjerë në një pozicion analog, për shembull me Kryeministrin aktual të Shqipërisë Edi Rama (**Arsyetimi 2**).
- (c) **Diskriminim:** Vendimi përfshinte diskriminim të paligjshëm në kundërshtim me Aktin e Barazisë së vitit 2010 (**Arsyetimi 3**).
- (d) **Mosmarrje në konsideratë e shqyrtimeve përkatëse:** Me marrjen e këtij vendimi SSHD nuk mori parasysh faktin se shënjestrimi i dikujt që nuk kishte qenë në pushtet për 10 vite, dhe anashkalimin e një personi aktualisht në pushtet (Z. Rama) do të sillte forcimin e sponsorizuesve të grupeve të krimit të organizuar (“OCG”), të cilët kanë pushtetin aktual dhe real (**Arsyetimi 4**).
- (e) **Marrje parasysh e shqyrtimeve të parëndësishme:** Vendimi i përjashtimit u bazua mbi dy faktorë të parëndësishëm: së pari, në faktin se të gjitha veprimet e kryera gjatë kohës që Dr. Berisha ishte President apo Kryeministër i Shqipërisë mbuloheshin nga imuniteti i sovranitetit (për të cilën shih Arsyetimin 6); dhe së dyti, pasojat negative të reputacionit që do të sillte heqja dorë nga përjashtimi i Dr. Berishës. Përveç kësaj, vendimmarrësi mori parasysh katër çështje faktike të cilave u mungonte baza e duhur e themelit provues dhe, edhe nëse kjo do të ishte e vërtetë, nuk do të mund të provonte se Dr. Berisha përbën rrezik për MB, përkatësisht: (i) rënia e skemave piramidale në vitin 1997; (ii) pretendimin se një park energjetik u zgjerua për të pasuruar z. Fazlliç; (iii) pretendimet e Zafar Ansar se në vitin 2008 zonja Malltezi u përpoq ta shantazhonte duke përdorur marrëdhënien e saj me Dr Berishën; dhe (iv) pretendimin se Dr. Berisha nxiti Fation Dautin të angazhohej në sjellje të dhunshme (shkelmimin e derës së selisë së Partisë Demokratike në emër të Dr Berishës) (**Arsyetimi 5**).
- (f) **Imuniteti i sovranit, kreut të shtetit dhe kreut të qeverisë:** Vendimi ishte i paligjshëm për sa kohë ai u mbështet në veprime të kryera apa mosveprime gjatë periudhës kur Dr Berisha ishte kryetar i shtetit ose kreu i qeverisë së Shqipërisë (**Arsyetimi 6**).

- 8 Ka dy çështje paraprake për t'u vendosur. E para lindi nga një kërkesë e bërë nga Avokatët e Posaçëm për zbulimin e materialeve që thuhet se janë të rëndësishme për Arsyetimin 2, në përputhje me rregullin 4 (3) të (Procedurës) së Komisionit të Posaçëm të Apelimit për Imigracionin, Rregullat 2003 (“Rregullat”). Materiali në fjalë u përshkrua në një burim të HAPUR të një procesverbali të Adam Straw KC i datës 7 dhjetor 2023 si më poshtë: “çdo material në posedimin e të Paditurit më datë 12 korrik 2022, të cilat sugjerojnë lidhje me krimin e organizuar dhe korrupsion në lidhje me palë të treta”. Kjo kërkesë na u rendit fillimisht në një seancë dëgjimore të MBYLLUR në dhjetor 2023. Ne urdhëruam që kërkesa të rimerrej me njoftim nga përfaqësuesit si burim i HAPUR dhe dhamë udhëzime për një burim të HAPUR të parashtrësave të Avokatëve të Posaçëm dhe të SSHD-së për t’iu dhënë Dr Berishës. Kjo u dëgjua në fillim të seancës dëgjimore përmbajtësore të ankimit. Ne refuzuam dhënien e çfarëdo urdhri sipas rregullit 4(3) dhe u shprehëm se do të jepnim arsyet tona së bashku me arsyet për të vendosur kërkesën përmbajtësore.
- 9 Çështja e dytë paraprake lindi nga parashtrësja e SSHD-së se deklaratat e tre dëshmitarëve dhe mijëra faqet e materialit shoqërues provues të depozituar në emër të Dr. Berishës më datë 7 shkurt 2024 ishin të papranueshme sepse nuk ishin para vendimmarrësit dhe në këtë mënyrë ishin të parëndësishme për një rishikim të këtij vendimi ku aplikohen parimet e rishikimit gjyqësor. Ne u shprehëm se nuk do t'i linim jashtë këto dëshmi në nisje të procesit. Përkundrazi, ne do ta lejonim zotin Randolph të drejtonte vëmendjen tonë në pjesët e kësaj prove në të cilat ai dëshironte të mbështetej dhe të shpjegonte arsyet se pse ato ishin të rëndësishme në parashtrësat e tij verbale. Për këtë arsye, ne do të shqyrtojmë çështjen e pranueshmërisë së bashku me kërkesën përmbajtësore.

Arsyet për përjashtim me burim të HAPUR të SSHD-së

- 10 Arsyet e Hapura të SSHD-së për vendimin e datës 27 shkurt 2023 për të ruajtur vendimin e përjashtimit, pavarësisht nga përfaqësitë e depozituara në emër të tij, mund të gjenden në një parashtrësë ministrore të datës 21 shkurt 2023, me anekse. Përmbledhja e mëposhtme përmendet në parag. 42 të Aneksit D:

“Vihet re se nuk ka qenë e mundur të provohet mjaftueshëm se Berisha ka lidhje personale me Dautin. Megjithatë, raportimet e mediave me burim të hapur, raportimet e brendshme, raportimet e Departamentit të Shtetit të SHBA-së dhe provat e mëtejshme të përshkruara në Aneksin E kanë siguruar prova me përmbajtje thelbësore dhe të besueshme, që e implikojnë Berishën në krim dhe korrupsion të rëndë e të organizuar. Kjo përfshin një vlerësim për një nivel të konsiderueshëm korrupsioni që ndodh gjatë gjithë kohës së Berishës si Kryeministër (qoftë kjo e drejtuar nga ai vetë ose nga anëtarët e partisë së tij, i cili, për shkak të nivelit të kontrollit të tij mbi partinë, duhet të jenë bërë me dijeninë dhe/ose autorizimin e tij) dhe një vlerësimi se Berisha ka ndërhyrë në hetimin për Fazllic dhe se blerja nga Fazllic i tokës në kufi me parkun energjetik të Porto Romanos kërkonte me shumë mundësi përdorimin e një informacioni nga brenda. Gjithashtu vlerësohet se Berisha ka përfituar nga lidhjet me kriminelë dhe veprimtaritë kriminale.”

- 11 Znj. Giovannetti parashtrroi se ky vlerësim mund të ndahet në komponentët e mëposhtëm kyç:

- (a) Një nivel mjaft të lartë korrupsioni ka pasur gjatë kohës së Berishës si Kryeministër. Aneksi B përfshin sa më poshtë në vijim:

“Prova të një abuzimi më të gjerë me pushtetin si Kryeministër

24. Raportimi i brendshëm tregon për abuzim me pushtetin nga ana e Berishës me emërimin e zyrtarëve të korruptuar, ndërhyrjeve në sistemin gjyqësor të Shqipërisë për të mbrojtur vartësit nga hetimi dhe procedimet gjyqësore, dhe survejimin e paligjshëm të kundërshtarëve politikë.

Korrupsion i përhapur nga Berisha dhe qeveria e tij, veçanërisht me afrimin e zgjedhjeve të vitit 2013

25. Raportimi i brendshëm ofron një pamje konsistente dhe të qartë të një korrupsioni të përhapur masiv gjatë gjithë periudhës së qeverisjes së Berishës, por veçanërisht në kandidimin e tij në zgjedhjet e vitit 2013. Ky korrupsion u përdor për të çuar me tutje interesat e tij, ndihmuar aleatët dhe blerë suportin e tij politik.

Kontrolli i ngushtë politik i Berishës dhe dominimi i qeverisë së tij

26. Kryesisht, raporti i brendshëm tregon se korrupsioni i përhapur masiv i qeverisë së tij nuk mund të ndodhte pa dijeninë dhe autorizimin e Berishës duke pasur parasysh kontrollin e ushtruar prej tij gjatë Qeverisjes së tij.”

U morën në konsideratë parashtrësit e Dr. Berishës, duke përfshirë në veçanti hapat që ai pretendon se ka marrë për të luftuar korrupsionin si edhe përfshirjen e politikanëve të tjerë në korrupsion. Kjo u vlerësua si e pavend, sepse edhe sikur të ishte e vërtetë që persona të tjerë (si p.sh. pasardhësi i tij në krye të Partisë Demokratike, Lulzim Basha) të kishin qenë të përfshirë në korrupsion, kjo nuk do të nënkuptonte se Dr. Berisha nuk ishte i përfshirë në të (shih parag. 35 të Aneksit B).

- (b) Ndërhyrje në hetimin e Fazliç:

(i) Burimi i HAPUR raporton për Fazliçin, i cili ishte mik dhe këshilltar zgjedhor i Dr. Berishës dhe një klient ligjor i vajzës së tij dhe i cili u hetua në Shqipëri për pastrim parash. Në faqen e internetit të Balkan Insight ekziston një artikull mbi efektin se hetimi ishte subjekt i “një presioni intensiv politik mbi prokurorinë nga qeveria dhe [Dr. Berisha]” dhe raportim të brendshëm me të njëjtin efekt. Raporti i vitit 2008 i Departamentit të Shtetit Amerikan doli në të njëjtën përfundim.

(ii) Në deklaratën e tij të parë dhe të dytë të dëshmitarit, Dr. Berisha nuk iu adresua akuzës se ai kishte ushtruar presion ndaj organeve të prokurorisë, por pohoi se hetimi ndaj Fazliçit nuk ka vërtetuar asnjë shkelje nga ana e tij. Ekipi i CSNP-së nuk pranoi që Fazliç të ishte shfajësuar, duke marrë parasysh raportin e burimit të hapur se çështja u pushua sepse prokurorët e kishin të pamundur të aksesonin dokumentet kryesore, konkluzionet e Departamentit të Shtetit të SHBA-së për vështirësinë e ndjekjes së çështjeve penale kundrejt zyrtarëve, politikanëve, gjyqtarëve dhe personave me interesa të fuqishëm biznesi dhe raportin e burimit të hapur

se ishte ushtruar presion nga qeveria dhe Dr Berisha në veçanti.

- (c) përvetësimi i tokave në kufi me parkun energjetik të Porto Romanos nga ana e Fazlliçit kërkonte me shumë mundësi përdorimin e një informacioni nga brenda:
- (i) Raportimi me burim të hapur tregon se: vajza e Dr Berishës, Argita Malltezi, e larguar nga një punë në OKB disa muaj pasi Dr Berisha u emërua Kryeministër në vitin 2005, për të hapur një zyrë ligjore në Tiranë; me ndihmën e bashkëshortit të saj, zonja Malltezi punësoi një ndërmjetës për të blerë tokë nga fshatarët në kufi të një parku energjetik; Bashkëshorti i zonjës Malltezi pranoi se ai kishte informacion në lidhje me zhvillimi e kësaj zone; Zoti dhe zonja Malltezi morën një përfitim financiar kur toka iu shit Fazlliçit; dhe tokës më pas iu rrit vlera tetëfish kur qeveria zgjeroi parkun energjetik aty pranë.
 - (ii) Ekipi i CSNP-së shqyrtoi me kujdes përfaqësitë e Dr Berishës. Ato e hodhën poshtë shpjegimin e tij (se do të ishte “i palogjikshëm dhe joproportional” zgjerimi i një parku energjetik për t’i siguruar një përfitim Fazlliçit). Por ishte qartazi i dukshëm qëllimi për të rritur madhësinë e parkut energjetik si dhe për tu përfshirë në korrupsion. Dëshmia e zonjës Malltezi se ajo nuk kishte përfituar nuk ishte bindëse, duke qenë se: kundërshtohet nga raporti i burimit të hapur; ekzistonte një dokument me nënshkrimin e saj; si edhe u siguruan përfitime të mëdha nga blerja e tokës së cilës pwr pasojw do t’i rritej vlera.
 - (iii) Raporti i vitit 2008 i Departamentit të Shtetit të SHBA-së ofroi një bazë të vlefshme duke dalë në përfundimin se Dr Berisha e kishte mbrojtur Fazlliç nga ndjekja penale.
- (d) Dr Berisha përfitoi nga lidhjet me kriminelët dhe aktivitetet kriminale:
- (i) Ka raportime të brendshme që tregojnë lidhjet e Dr. Berishës me kriminelin dhe kriminelin e organizuar dhe gatishmërinë e tij për të inkurajuar mbështetësit politikë të përfshihen në dhunë. Ka gjithashtu raportim me burim të hapur nga dhjetori i vitit 2021 ku shfaqen pamjet video të kriminelit të njohur shqiptar Fation Dauti duke shkelmuar me dhunë një derë të selisë së Partisë Demokratike në emër të Dr Berishës. Për Dautin është marrë vendimi i përjashtimit nga Britania e Madhe për shkak se vlerësohet se ka pasur një rol drejtues në një grup të krimit të organizuar. SIAC ka gjetur se Dauti është një anëtar me ndikim i një grupi me bazë në Mbretërinë e Bashkuar që importon dhe shpërndan drogë të klasit A në MB dhe se është i përfshirë në dhunë ekstreme.
 - (ii) Ekipi i CSNP-së mori parasysh deklaratën e Dr. Berishës se ai nuk e njohte Dautin, por kjo u refuzua në bazë të raportimit të brendshëm dhe vlerësimit të videos së tyre. Parashtrësja ministrore pranoi se afërsia e Dautit me Dr Berishën në video nuk vërtetonte domosdoshmërisht një lidhje personale mes të dyve, edhe nëse ajo sugjeronte mundësinë e një lidhje të tillë. Megjithatë, u pranua vlerësimi se Dr. Berisha kishte qenë i lidhur me kriminelë dhe grupe të krimit të organizuar dhe se ai kishte përfituar nga këto lidhje. Se Dr Berisha ishte i gatshëm të përdorte lidhjet

kriminale për përfitime të tij u konfirmua disi nga videoja, e cila tregoi se Dr Berisha ishte i gatshëm të përfitonte nga dhuna e Dautit.

E drejta ligjore

E drejta e përjashtimit

- 12 Mbi baza ligjore, SSHD gëzon të drejtën për të urdhëruar përjashtimin e një personi nga MB . Ka një debat për burimin e vërtetë të pushtetit. Në çështjen *Cakani kundër SSHD* [2013] EWHC 16, Ingrid Simler QC (në pozicionin e Zëvendës Gjyqtarës së Gjykatës së Lartë) tha se kjo rridhte nga kompetencat e përgjithshme të dhëna nga Akti i Imigracionit të vitit 1971. Në çështjen *Geller kundër SSHD-së*[2015] EWCA Civ 45, në [1], përjashtimi u tha se ishte drejtuar nën pushtetin prerogativ dhe gjithashtu sipas Rregullave të Imigracionit. Cilido qoftë burimi, ekzistenca e pushtetit reflektohet në s. 2C të Aktit të vitit 1997, i cili i jep SIAC të drejtën e apelimit. Paragrafët përkatës të Rregullave të Imigracionit (përkatësisht paragrafët 9.2.1 dhe 9.2.2) kërkojnë përpilimin e një kërkesë për leje hyrjeje (entry clearance), leje për hyrje ose leje qëndrimi për t'u refuzuar kur SSHD ka urdhëruar personalisht që aplikanti të përjashtohet nga MB dhe çdo leje ekzistuese hyrje ose lejim të anulohet kur SSHD e ka urdhëruar këtë. Për sa i përket rëndësisë së Rregullave të Imigracionit si një burim i mundshëm i fuqisë për të përjashtuar, shih Vendimin e SIAC në *T2 kundër SSHD* (SN/129/2016), 5 janar 2018, në [49]-[52] (Elisabeth Laing J, UTI Gill dhe Neil Jacobsen OBE).

Udhëzimi i Ministrisë së Brendshme (Home Office) mbi përjashtimin

- 13 Zyra e Ministrisë së Brendshme (Home Office) lëshoi udhëzimin për ushtrimin e pushtetit të përjashtimit më 26 Nëntor 2021. Ai parashikon që vendimet e përjashtimit të mund të merren në bazë të "kriminalitetit" ose "korrupsionit". Përsa i përket të parës, udhëzimi përfshin sa më poshtë:

“ Dënimi nuk është i nevojshëm për të konsideruar një person për përjashtim. Nëse aktivitetet e personit bien në fushëveprimin e legjislacionit penal të Mbretërisë së Bashkuar (ose në sjellje të ndaluara me ligj), pavarësisht nëse individi është apo jo i akuzuar ose i dënuar për një shkelje, atëherë përjashtimi mund të justifikohet.”

- 14 Përsa i përket korrupsionit, udhëzimi përfshin sa më poshtë:

“Nuk ka asnjë përkufizim të pranuar të korrupsionit. Një sërë organizatash duke përfshirë Transparency International e përkufizojnë korrupsionin si ‘abuzim i pushtetit të besuar për fitime private’.

Llojet e aktiviteteve që lidhen me korrupsionin përfshijnë, por nuk janë të kufizuara, sa më poshtë:

- evazionin fiskal
- pastrimin e parave
- ryshfetin dhe pranimin e shantazhit (pjesë e një të ardhure që i paguhet një personi si kompensim për një mundësi përfitimi, shpesh nga disa marrëveshje të paligjshme)
- zhvatjen
- vjedhjen e aseteve
- mashtrimin

- shitjen e ndeshjeve sportive.

Ky person nuk është e thënë që të jetë dënuar për një vepër penale korrupsioni në mënyrë që të përjashtohet. Në rastin kur ka informacione thelbësore, të besueshëm që një person ka qenë i përfshirë në korrupsion kjo do të duhet të merret parasysh.” (Theksim i shtuar)

- 15 Nën titullin “Vlerësimi i rasteve”, udhëzimi përfshin këtë:

“Një rekomandim për të përjashtuar një individ nga MB duhet të bazohet në prova të besueshme. Kjo mund të përfshijë verifikimin e të dhënave penale, veçanërisht kur rekomandimi është që personi të përjashtohet në bazë të kriminalitetit në MB ose jashtë tij. Në raste të tjera, provat mund të mos jenë aq të drejtpërdrejta dhe një shkallë më e madhe shqyrtimi dhe vlerësimi mund të kërkohet.

Faqet e internetit mund të jenë burime informacioni të dobishme, por ju duhet të tregoni kujdes kur përdorni butonin e kërkimit në internet. Për shembull, ata mund të sugjerojnë që një individ ka thënë ose ka bërë diçka që do të justifikonte përjashtimin, por informacioni i faqes në internet në fakt përsërit vetëm pretendimet nga faqet e tjera të internetit, të cila janë të gabuara.”

Metoda që aplikohet nga SIAC në një kërkesë për rishikim të një vendimi përjashtimi

- 16 Kur shqyrton një vendim për përjashtim, SIAC i kërkohet nga s. 2C e Aktit të vitit 1997 të vërë në zbatim parimet që do të aplikoheshin në një kërkesë për rishikim gjyqësor. SIAC regjistroi parashtesat e SSHD-të në bazë të asaj që kjo nënkuptonte në T2 në [21]:

“Ne duhet ta shqyrtojmë me kujdes materialin e mbyllur, duke pasur parasysh mundësinë që mund të ketë shpjegime të tjera, ndoshta të pafajshme për kundërshtimin e vendimit. Ne nuk jemi të detyruar të shqyrtojmë të gjithë materialin që mund të ketë qenë në dispozicion të zyrtarit që ka shkruar parashtesën për Sekretarin e Shtetit dhe që solli dhënien e këtij vendimi, por ‘materialin themelor mbi të cilin [autori i parashtesës drejtuar Sekretarit të Shtetit] u mbështet në të vërtetë në mënyrë që të identifikonte faktet ose arrinte në përfundim.’ Ky material nuk duhet të jetë shterues i asaj që dihet, por duhet të jetë i mjaftueshëm për të justifikuar përmbajtjen e parashtesës. Një rishikim është ‘një analizë faktesh dhe bazë faktesh që çuan në rekomandimin ose përfundimin, së bashku me vendimin dhe arsyetimin e tij. Ky material duhet të jetë i mjaftueshëm për të lejuar kundërshtimin, nëse është i duhuri, ‘racionalitetin bazë të cilësdo pjesë të vendimit.’”

- 17 Në [22], SIAC e pranoi këtë parashtesë dhe u shpreh kështu:

“Kuptohet/ se ne nuk jemi të shqetësuar për faktin nëse akuza e bërë haptazi kundër T2 është e vërtetë, por nëse ka pasur prova para Sekretares së Shtetit për të cilën ishte e hapur për të në mënyrë të arsyeshme që të konkludonte se pretendimi ishte i vërtetë. Kuptohet se dëshmia e T2 për ne, duke mohuar pretendimin, është i parëndësishëm.”

- 18 Praktika gjyqësore për shqyrtim gjyqësor e bën të qartë se standardi i rishikimit është i ndjeshëm ndaj kontekstit. Kur vendimi i kundërshtuar përfshin të drejtat themelore të njeriut, gjykata do të aplikojë “këqyrje të kujdesshme e të shqetësuar”: shih p.sh. *Bugdaycay kundër SSHD* [1987] AC 514, 531 (Lord Bridge); shih gjithashtu *Kennedy kundër Komisionerit të Informacionit* [2014] UKSC 20, [2015] AC 455, [54] (Lord Mance).
- 19 Në një fazë, z. Randolph sugjeroi se vendimi i kundërshtuar këtu kishte efektin e kufizimit të lirisë së Dr. Berishës për të hyrë në Mbretërinë e Bashkuar, si dhe një efekt negativ përmbajtësor në reputacionin e tij; dhe se në përputhje me rrethanat, ndërhyri në të drejtat e tij themelore duke e bërë këtë një kontekst ku të urdhërohej një këqyrje e kujdesshme dhe e shqetësuar e njëjtë me atë të referuar në *Bugdaycay*. Në argumentimin verbal, ne kërkuam testimin e këtij propozimi dhe nuk e kuptuam insistimin e Zotit Randolph për të vazhduar me të. Në cilindo rast, ky është i gabuar sipas këndvështrimit tonë.
- 20 Në përgjithësi, shtetasit e huaj që nuk janë këtu shtetas apo rezidentë të Mbretërisë së Bashkuar nuk kanë të drejtë hyrje në MB, qoftë si çështje e legjislacionit vendas apo atij ndërkombëtar. Shtetasit shqiptarë (së bashku me shtetasit e vendeve të tjera në listën kombëtare të vizave) duhet të kërkojnë leje hyrje për çdo vizitë në MB, sado e shkurtër qoftë kjo. Një aplikant nuk ka pritshmëri legjitime se kërkesa e tij do të pranohet; vendimi i takon qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar. Efekti i një vendimi përjashtimi është thjesht për të shkurtuar procesin e shqyrtimit të një kërkesë për leje hyrje (ose lejen për të hyrë) duke siguruar paraprakisht informacionin se kjo kërkesë do të refuzohet. Ndryshe nga një vendim për t'i privuar një shtetas të Mbretërisë së Bashkuar nënshtetësinë e tij, ose për të dëbuar një individ i cili është fizikisht i pranishëm në MB, ose për t'i ngrirë asetet, një vendim për të përjashtuar një shtetas të huaj nga MB nuk heq ose ndërhyr në cilëndo të drejtë të mëparshme ose status të mbajtur nga individi i përjashtuar.
- 21 Ne pranojmë se vendimi për të përjashtuar një shtetas të huaj nga MB mund, në një rast të veçantë, të ketë pasoja të konsiderueshme për individin e përjashtuar ose për të tjerët. Ky mund të jetë rasti nëse, për shembull, individi ka familjarë në MB. Nuk ka asnjë provë, megjithatë, që sugjeron se ky është pozicioni i Dr. Berishës; dhe Dr. Berisha nuk u mbështet në asnjë nga të drejtat sipas Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (“KEDNJ”), qofshin këto të drejta të tij apo të tjerëve. Në pamje të parë, duke qenë se Dr Berisha është jashtë juridiksionit, neni 1 i ECHR nuk i imponon Mbretërisë së Bashkuar asnjë detyrim për të siguruar të drejtat e tij sipas Konventës.
- 22 Ne pranojmë gjithashtu se një vendim përjashtimi mund të ketë pasoja në reputacion, por e njëjta gjë vlen edhe për shumë vendime të marra nga qeveritë për shtetasit e huaj. Këto pasoja reputacioni, në pikëpamjen tonë, nuk i vënë vendimet e përjashtimit në kategorinë e vendimeve që përfshijnë ndërhyrjen në një të drejtë themelore.
- 23 Kjo nuk nënkupton se vendimi është imun nga kërkesat e zakonshme të së drejtës publike. Ai duhet të ketë ende një bazë të mjaftueshme provuese; duhet të jetë racional; nuk duhet të jetë i zhylerësuar nga çfarëdolloj gabimi material i faktit të provuar ose mosndjekje të paarsyeshme të politikës së zbatueshme ose shkelje të pritshmërisë legjitime; dhe vendimmarrësi duhet të marrë parasysh të gjitha konsideratat përkatëse të detyrueshme dhe jo ato të parëndësishme. Por kjo nuk kërkon nivel të lartë kontrolli të imtësishëm që kërkohet për vendimet që ndërhyjnë në të drejtat themelore.

Kërkesa e Avokatëve të Posaçëm për zbulimin e informacionit

- 24 Kërkesa e Avokatëve të Posaçëm për zbulimin e informacionit, siç e kemi thënë, u ndoq kryesisht në format të HAPUR. Kjo do të thotë se z. Randolph ishte në gjendje të bënte parashtrës në mbështetje të saj. Kërkesa kishte si objektiv “çdo material në zotërimin e palës së paditur më datë 12 korrik 2022 të cilat sugjeronin lidhje me krimin e organizuar dhe korrupsion në lidhje me palë të treta”. Ajo u zgjerua për të përfshirë materialet e poseduara nga i Padituri në kohën e vendimit të dytë më datë 27 shkurt 2023.
- 25 Ky material u tha se ishte i rëndësishëm për arsyetimin 2 – argumenti se SSHD veprroi në mënyrë irracionale duke dalluar në mënyrë arbitrare midis Dr Berishës dhe personave të tjerë në një pozitë analoge. *Banka Mellat kundër Thesarit të Madhërisë së Saj* [2013] UKSC 39, [2014] AC 700, një sfidë për vendosjen e kufizimeve financiare që arriti në praktikë ngrirjen e qindra milionë paundëve të mbajtura nga një bankë iraniane u përdor si mbështetje. Kundërshtimi (padi) u paraqit para Gjykatës së Lartë pjesërisht sepse qëllimi i masës ishte kufizimi i aksesit të regjimit iranian në sistemin bankar ndërkombëtar, por Qeveria nuk kishte vendosur kufizime për bankat e tjera iraniane. Dallimi ndërmjet Bankës Mellat dhe bankave të tjera ishte arbitrar dhe i paarsyeshëm. Fakti që ishin vendosur kufizime më të vogla ndaj bankave të tjera në pozicione të krahasueshme nënkuptonte se kufizimet e vendosura në Bankën Mellat ishin të panevojshme: shih [25]-[27] (Lord Sumption).
- 26 Lord Sumption përdori si referencë *A kundër SSHD* [2004] UKHL 56, [2005] 2 AC 68, ku u mbështetën gjithashtu Avokatët e Posaçëm dhe z. Randolph. Në këtë rast, Shtëpia e Lordëve u shpreh se ndalimi pa gjyq i të dyshuarve të huaj për terrorizëm që nuk mund të largoheshin nga vendet e tyre të origjinës ishte joproporcional duke qenë se masa nuk zbatohet për të dyshuarit për terrorizëm në Mbretërinë e Bashkuar, të cilët përbënin një kërcënim të ngjashëm. Aspekti diskriminues i masës ishte çelësi për mungesën e proporcionalitetit.
- 27 Avokatët e Posaçëm dhe z. Randolph parashtruan se këto raste treguan se një masë mund të jetë irracionale në të drejtën zakonore nëse aplikimi për një individ, dhe jo për individë të tjerë në një pozicion të ngjashëm, përfshin një dallim arbitrar. Kjo ishte veçanërisht e tillë ku u duk moszbatimi i masës ndaj individëve të tjerë, në mungesë të një shpjegimi, se nuk ishte pikërisht kjo që kërkohet dhe karakteri diskriminues i masës zhvlerësoi efektivitetin e saj si një mjet për të arritur qëllimin e saj.
- 28 Kur trajtojmë arsyetimin 2, është e nevojshme të themi diçka më shumë mbi këtë argument nga ana përmbajtëse. Megjithatë, për qëllimet e tanishme shtrohet pyetja nëse SSHD është e detyruar të zbulojë materiale në lidhje me palët e treta në një pozicion potencialisht analog. Avokatët e Posaçëm shprehen se ne duhet të urdhërojmë zbulimin e këtij materiali në përputhje me rregullin 4(3) të Rregullave të Procedurës SIAC sepse një zbulim i tillë është i nevojshëm për përcaktimin e arsyetimit 2. SIAC mund të japë një gjykim të duhur vetëm nëse vendimi i SSHD është zhvlerësuar nga arbitrariteti nëse mund të merret parasysh se cilat prova ishin vënë në dispozicion të nënpunësve civil përgjegjës për ekipin e CSNP e cila këshilloi SSHD-në.
- 29 Lisa Giovannetti KC për SSHD-në përgjigjet duke iu referuar provës rreth CSNP-së. Kjo filloi në mars 2021 për të ndaluar lidhjet midis politikanëve dhe kriminelëve në Ballkanin Perëndimor. Zyrtarët zgjodhën një numër objektivash për përjashtim duke pasur parasysh nevojën për të promovuar objektivat e qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar në Shqipëri duke minimizuar rrezikun ndaj prioritetëve të tjera të Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar. Një grup fillestar personash ishte identifikuar si pjesë e listës të rekomanduar për përjashtim, mes të cilëve ishte edhe Dr Berisha. Grupi

ishite politikisht i balancuar në kuptimin që u zgjodh për të siguruar që veprimi i Mbretërisë së Bashkuar të mos shënjestronte në mënyrë disproporcionale një parti të caktuar politike. Prandaj, ky nuk është rasti kur SSHD ka vendosur të shënjestrojë A-në, por jo B-në. Përkundrazi, SSHD-së iu dha një listë individësh të rekomanduar për përjashtim. Vendimi për të përjashtuar grupin e parë nuk nënkuptonte një vendim për të mos përjashtuar dikë tjetër. Përkundrazi, ekipi i CSNP-së e bëri të qartë se ky ishte një grup fillestar. Asnjë tjetër nuk është përfshirë ose përjashtuar nga grupi.

- 30 Znj. Giovanetti parashtrori se logjika e argumentit të Dr Berishës është se, përpara se të vendoset të përjashtohet personi X, SSHD duhet të marrë parasysh rrethanat e të gjithë personave të tjerë të cilët mund të kualifikohen për përjashtim. SSHD nuk e bëri këtë - dhe çdo kërkesë për ta bërë këtë do të ishte e pazbatueshme. Por nëse kjo është me të vërtetë ajo që kërkon e drejta publike, SIAC mund ta japë vendimin pa i shqyrtuar vetë provat që kanë të bëjnë me personat e tjerë që janë ose mund të jenë në një pozitë të ngjashme.
- 31 Në pikëpamjen tonë, kërkesa për zbulimin e informacionit nuk mund të arrihet për arsyen e mëposhtme. Në dëshminë e dhënë para nesh, as SSHD dhe as ndonjë zyrtar që punon për SSHD - qoftë në ekipin e CSNP-së ose jashtë tij – nuk e ka marrë ndonjëherë parasysh materialin e mbajtur në lidhje me persona të ndryshëm, me përjashtim të personave pjesë e grupit fillestar. Me të drejtë mund të supozohet që SSHD disponon material që ka të bëjë me persona që nuk janë marrë parasysh në grupin fillestar; do të ishte shumë e habitshme, nëse SSHD nuk do ta bënte një gjë të tillë. Nëse argumentimet e Dr. Berishës në arsyetimin 2 janë të shëndosha, mosmarrja në konsideratë e këtij materiali do ta bënte vetë vendimin të paligjshëm dhe vendimi do të anulohet dhe kjo do t'i kalonte SSHD-së që materiali të mund të merret parasysh. Nëse jo, kjo do të jetë për shkak se SSHD nuk është e detyruar që të konsiderojë materialet që kanë të bëjnë me palët e treta. Sido që të jetë, ne nuk mund të shohim asnjë rrethanë në të cilën SIAC do të asistohet në këtë rast duke parë vetë materialin i cili nuk ishte marrë në konsideratë nga vendimmarrës ose cilido anëtar i ekipit të SSHD-së.

Arsyetimi 1

Parashtrësat për Dr Berishën

- 32 Sipas arsyetimit 1, z. Randolph parashtrori për çështjen e Dr Berishës se SIAC është i detyruar të marrë një vendim, në bazë të çështjeve të përcaktuara në Arsyetimet e Ndryshuara dhe provat shtesë të dorëzuara pas vendimit, se akuzat kundër Dr Berishës në të cilën u mbështet vendimi janë “pohime të rreme” dhe “gjetje faktesh të pambështetura në asnjë lloj prove dhe/ose të bazuara në pikëpamje që nuk mund të qëndrojnë në mënyrë të arsyeshme” (Aplikanti Skeleti Argumenti, parag. 55).
- 33 Çështjet e përcaktuara në Arsyetimet e Ndryshuara (në paragrafin 12) ishin: (i) mungesa e provave të drejtpërdrejta që tregojnë shkelje në lidhje me shitjen dhe blerjen e tokës tek Damir Fazllic; (ii) mungesa e provave, të drejtpërdrejta ose anasjelltas, që tregojnë një lidhje personale ndërmjet Dr Berishës dhe Fation Dautit; (iii) pranimi se komunikimet diplomatike ndërmjet Ambasadës së Mbretërisë së Bashkuar në Tiranë dhe FCDO në Londër, të cilat u morën si mbështetje përmbajtësore, “humbën”; (iv) ndryshimi i pozicionit në lidhje me pamjet video ku i padituri mbështetej (nga ku fillimisht shprehej se ajo "shfaqte" Dr Berishën duke organizuar dhe marrë pjesë në një protestë të dhunshme ku përfshiheshin kriminelë të njohur e deri “duke pretenduar/dyshuar” të njëjtën gjë); (v) pranimi i SSHD-së se Dr. Berisha ishte përpjekur të luftonte korrupsionin; (vi) pranimi se dyshimet për korrupsion kundër vajzës së Dr. Berishës nuk ishin një aspekt kyç i rekomandimit që çoi në përjashtimin e Dr. Berishës; (vii) pranimi i SSHD-së se burimet e HAPURA në të cilat ai mbështetet nuk ofrojnë prova konkrete për këto lidhje.

- 34 Provat e marra pas dhënies së vendimit u shqyrtuan me shumë kujdes: (i) presioni i supozuar i ushtruar nga Dr Berisha mbi prokurorin publik në lidhje me një hetim për Damir Fazllic; (ii) mësymja e selisë së Partisë Demokratike; (iii) përpjekjet e Dr. Berishës për të luftuar krimin e organizuar dhe korrupsionin; (iv) lidhjet e zyrtarëve të tjerë të lartë me krimin e organizuar dhe korrupsionin; (v) përfshirjen e Fazllicit në një marrëveshje korruptive telekomunikacioni me Albtelecom; dhe (vi) rënia e skemave piramidale.
- 35 Z. Randolph u mbështet në parimin e themeleve të forta se një vendim i marrë pa asnjë provë ose mbi një këndvështrim faktesh të cilat nuk mund të pranohen në mënyrë të arsyeshme është e paligjshme: *Edwards kundër Bairslow*[1956] AC 14. Ai gjithashtu u mbështet në vendimin e Gjykatës së Apelit në çështjen *E kundër SSHD* [2004] EëCA Civ 49, [2004] QB 1044, e cila vendosi se çfarë zakonisht konsiderohet si një argument i ri për rishikim gjyqësor: gabim material i faktit të vërtetuar. SIAC mund t'i konsideronte siç duhet provat e paraqitura para tij, duke përfshirë edhe ato prova që nuk ishin paraqitur përpara SSHD, si të mjaftueshme për të treguar se se në të gjendej një gabim material i faktit të vërtetuar.
- 36 Për sa i përket faktit që pjesa më e madhe e provave të Dr. Berishës datonin pas vendimit, zoti Randolph pranoi se provat pas vendimit nuk pranohen përgjithësisht në procedurën e shqyrtimit gjyqësor. Megjithatë, zoti Randolph e paraqiti këtë provë që vërteton objektivisht se një pjesë materiale e vendimit është faktikisht e gabuar dhe përjashtim nga ky parim dhe do të ishte e pranueshme për të vërtetuar një gabim të faktit të provuar. Në çdo rast, aplikimi i përfaqësjes së çështjes *R kundër SSHD ex p. Turgut* [2001] 1 All ER 719, siç citohet me miratim në çështjen e *E-së*, në një çështje që përfshin interesa themelore si këto, prova nuk është rreptësisht e kufizuar ndaj provës përpara SSHD.
- 37 Z. Randolph parashtroi se provat e reja ishin gjithashtu të pranueshme sepse, në një shkresë të datës 8 mars 2024 nga Departamenti Ligjor i Qeverisë (“DLQ”), u tha se provat e reja ishin konsideruar “në një nivel të lartë dhe jo në detaje” dhe “meritat e tij të gjera të vlerësuara” dhe “nuk u identifikua asnjë material që çon në përfundimin se vendimi i përjashtimit duhet të rishqyrtohet”. Ky mund të trajtohet si një vendim i ri, bazuar në të gjithë materialin e atëhershëm përpara SSHD-së, duke përfshirë provat e reja të mbështetura nga Dr Berisha.
- 38 Së fundi, në përgjigjet e tij parashtruese, z. Randolph tërhoqi vëmendjen tonë te korrespondenca nga e cila avokatët e tij udhëzues kishin kuptuar se përfaqësive të ftuara iu dha informacion i cunguar nga materiali i HAPUR i zbuluar fillimisht si bazë për vendimin e parë të datës 19 korrik 2022, dhe jo dokumentet e zbuluara pas kësaj date; dhe vetëm pas vendimit të dytë u bënë të qarta pjesë të mëdha të çështjes kundër Dr Berishës.

Parashtruesat për SSHD

- 39 Znj. Giovannetti për SSHD parashtroi se vendimi operativ i sfiduar (nw kundërshtim) ishte vendimi i datës 27 shkurt 2023. Dr. Berishës i ishte dërguar një pjesë e madhe e materialit të HAPUR dhe se ai pati rastin të japë komentet e tij. SSHD kishte të drejtë të procedonte mbi bazën se përfaqësimet e marra ishin tërësia e atyre që Dr Berisha dëshironte të kishte. Ligjshmëria e vendimit pritet të vlerësohet në bazë të provave të vëna përpara vendimmarrësit kur vendimi merret, jo në prova që datojnë pas marrjes së vendimit. Rasti i *E-së* provon gabim material të faktit të vërtetuar si një bazë rishikimi, por vetëm kur katër kushte janë përmbushur. Këto ishin të përcaktuara nga Carnwath LJ në [66]:

“Së pari, duhet të ketë pasur një gabim në lidhje me një fakt ekzistues, duke përfshirë një gabim për sa i përket disponueshmërisë së provave për një çështje të caktuar. Së dyti, fakti ose prova duhet të jetë ‘e provuar’, në kuptimin që ajo të ishte e pasfiduar dhe objektivisht e verifikueshme. Së treti, ankuesi ose këshilltarët i tij nuk duhet të kenë qenë përgjegjës për gabimin. Së katërti, gabimi duhet të ketë luajtur një rol material (jo domosdoshmërisht vendimtar) në ... arsyetim.” (Theksim i shtuar.)

- 40 Në këtë rast, provat pas marrjes së vendimit nuk tregojnë se vendimi ka pasur ndonjë gabim të faktit të “provuar” në kuptimin përkatës. Shkresa e datës 8 mars 2024 nuk përbën një vendim të mëtejshëm. Vendimi i sfiduar është marrë personalisht nga SSHD. Shkresa e datës 8 mars 2024 nuk tregon më shumë sesa faktin se ekipet e CSNP-së dhe zyrtarët e Departamentit të Ministrisë së Brendshme (Home Office) vazhdojnë të mbajnë të njëjtin qëndrim në lidhje me vlerësimet kryesore mbi të cilat u bazua vendimi i datës 27 shkurt 2023.

Diskutim

A e kuptoi Dr Berisha në një shkallë të kuptueshme se përfaqësimet të cilat ai ishte ftuar të jepte ishin të limituara në materialet e dërguara së bashku me shkresën e datës 6 tetor 2022 ?

- 41 Rrjedha e ngjarjeve ishte si vijon.
- 42 Vendimi fillestar u mor më datë 19 korrik 2022. Përfaqësuesit e Dr. Berishës u ankuan se nuk iu dha mundësia për të bërë përfaqësimet. Më 6 tetor 2022, Departamenti Ligjor i Qeverisë (“GLD”) u përgjigj se SSHD mbante të njëjtin qëndrim dhe se nuk kishte asnjë kërkesë për të kërkuar përfaqësime para përjashtimit por në të gjitha rrethanat treguan se ata ishin të vendosur t’i jepnin materialin e mëtejshëm të bashkangjitur dhe t’i siguronin Dr. Berishës një mundësi për të ofruar përfaqësimet e tij rreth saj. SSHD propozoi që apelimi në SIAC të shtyhej gjatë kësaj kohe. Materiali i bashkangjitur përbëhej nga artikuj të burimit të hapur.
- 43 Më pas pati korrespondencë midis avokatëve të Dr. Berishës, Zaiwalla dhe Co. (“Zaiwalla”) dhe GLD në lidhje me orarin. Zaiwalla insistonte për një orar më të shkurtër. Kjo korrespondencë supozonte se materialet e bashkangjitura në shkresën e datës 6 tetor 2022 ishin materialet që po i kërkohehin Dr Berishës për të dhënë komentet e tij.
- 44 Më datë 20 tetor 2022, SIAC e shtyu apelimin deri më datë 14 nëntor 2022 në pritje të një rishqyrtimi të vendimit të sfiduar.
- 45 Në të njëjtën ditë, 20 tetor 2022, në orën 4:46 pasdite, GLD i dërgoi një email Zaiwalla “në lidhje me shtyrjen e rënë dakord të palëve, që ishte miratuar tanimë nga Komisioni”. Bashkangjitur email-it të GLD-së ishin dokumentet e mëtejshme që (u tha) se Dr. Berisha i kishte marrë sipas parag. 1 të Shënimit Praktik të SIAC, përkatësisht, përmbledhjen e HAPUR të parashtrës ministrore që rekomandonte përjashtimin e Dr Berishës (i plotësuar me anekse) dhe një skedul i HAPUR Scott. Në email, u tha se: “Kjo do t’i lejojë klientit tuaj që të shqyrtojë materialet përpara SSHD-së.”
- 46 Z. Randolph parashtrroi, sipas udhëzimeve, se Zaiwalla supozoi nga ky zinxhir korrespondence se përfaqësitë për të cilat ata ishin duke u ftuar për të depozituar ishin të kufizuara në materialet e burimeve të hapura të bashkangjitura në shkresën e datës 6 tetor 2022 letër, në bazë të së cilës

ishite rënë dakord edhe shtyrja, dhe nuk i përfshiu materialet e mëtejshme të bashkangjitura emailit të datës 20 tetor 2022.

- 47 Ne mund të shohim në të vërtetë se emaili i datës 20 tetor 2022 dhe bashkëngjitjet e tij erdhën si një surprizë. Nëse, pas marrjes së këtij emaili, Zaiwalla do të kishte thënë se i duhej më shumë kohë për të shqyrtuar materialet përmbajtësore të vendimmarrjes bashkangjitur këtij emaili, atëherë kjo do të kishte qenë një arsye e mirë për zgjatjen e shtyrjes, e cila ishte rënë dakord dhe dhënë në bazë të arsyetimit se Dr Berisha do të komentonte mbi materialin shumë më pak përmbajtësor që iu bashkëngjit shkresës së datës 6 tetor 2022. Megjithatë, me marrjen e këtij emaili, çdo marrës emaili me gjykim të shëndoshë do ta kuptonte se në të ishin bashkëngjitur materiale të cilat ftonin përfaqësimet. Sugjerimi se Dr. Berisha nuk ishte ftuar për të bërë përfaqësime në materialet e mëvonshme nuk u mbështet nga asgjë që GLD tha dhe nuk është e besueshme kur korrespondenca konsiderohet si një e tërë. Ne nuk e kuptojmë se për çfarë qëllimi tjetër dikush me gjykim të shëndoshë do të mendonte se pse po dërgohej materiali.
- 48 Dr. Berisha kishte padyshim një mundësi për të komentuar dhe bërë përfaqësime për këto materiale të mëtejshme bashkangjitur emailit të datës 20 tetor 2022. Ai nuk e shfrytëzoi këtë mundësi. Prandaj, ne konsiderojmë se SSHD kishte të drejtë të procedonte më tutje me arsyetimin se Dr. Berisha i kishte marrë materialet e vendimit me qëllim përpilimin e përfaqësimeve; dhe se përfaqësimet që ai dha më pas përfaqësonin gjithçka që Dr Berisha kishte për të thënë rreth këtyre materialeve. Pjesa e mbetur e analizës sonë vazhdon mbi këtë bazë.

Cili është vendimi i sfiduar?

- 49 Çështja tjetër që ne duhet të vendosim është nëse shkresa e datës 8 mars 2024 nga GLD përbën një vendim të ri, e cila e bën këtë të fundit të përshtatshëm që ne ta marrim në konsideratë këtë pjesë të dëshmisë së Dr. Berishës e cila u mor pas datës të vendimit të 27 shkurtit 2023.
- 50 Sipas këndvështrimit tonë, shkresa nuk përbën një vendim të ri. Vendimet e përjashtimit merren personalisht nga SSHD. Ky ishte rasti me vendimin fillestar të datës 19 korrik 2022 dhe vendimin pasues për të vazhduar me përjashtimin më datë 27 shkurt 2023. Nuk ekziston asnjë sugjerim në shkresën e datës 8 mars 2024 që SSHD e mori personalisht në konsideratë (madje në një nivel të lartë) provën e re voluminoze të Dr. Berishës; në të vërtetë, shkresa e tregon qartë se nuk e bëri një gjë të tillë.
- 51 Ka disa rrethana kur është e përshtatshme të atribuohen pikëpamjet e zyrtarëve duke komentuar mbi provat e depozituara në SIAC për SSHD dhe për t'i trajtuar këto pikëpamje si zëvendësuese ose përditësuese të vendimit të sfiduar: shih p.sh. *U3 kundër SSHD* (SC153/2018 dhe SC/153/2021), 4 mars 2022, [38]. *U3*, megjithatë, ishte një apelim sipas s. 2B të Aktit të vitit 1997, i cili është projektuar të jetë një "procedurë me një ndalesë". Shqyrtimet nën s. 2C nuk janë të projektuara në këtë mënyrë. Ato kërkohet që të kryhen sipas parimeve të zbatueshme në një kërkesë për rishikim gjyqësor. Këto parime kërkojnë që gjykata të fokusohet në mënyrë rigoroze në një vendim të veçantë, veçanërisht kur - sipas rastit këtu - është dhënë një mundësi për të përpiluar përfaqësimet përpara dhënies së vendimit: shih Udhëzuesin e Shqyrtimeve Gjyqësore të Gjykatës Administrative (2023), parag. 7.11.4 dhe rastin ligjor të cituar aty.
- 52 Nga kjo rezulton se vendimi i sfiduar këtu është ai i datës 27 shkurt 2023; dhe ligjshmëria e këtij vendimi i bie të vlerësohet në bazë të materialeve të paraqitura përpara vendimmarrësit kur ky vendim u mor.

- 53 Kjo do të thotë se prova e re e depozituar përpara SIAC pas vendimit të datës 27 shkurt 2023 është kryesisht e parëndësishme pasi ekzistojnë prova se ajo nuk u paraqit para vendimmarrësit. Ne e konsiderojmë këtë rezultat të jetë në përputhje me qasjen në pikën [22] të gjykimit të SIAC në T2, cituar në pikën [17] më sipër.
- 54 Ne kemi shqyrtuar me kujdes parashtresat e z. Randolph bazuar në çështjen *Turgut* (i cili, siç e thekson ai, është cituar me miratim në rastin e E-së). Megjithatë, ne nuk e marrim parasysh faktin se ai ndikon në qëndrimin e mbajtur më sipër. *Turgut* ishte një rast ku vendimi i sfiduar prekte të drejtat themelore; dhe gjykata duhej të merrte vetë në konsideratë nëse largimi i paditësit do të ishte në kundërshtim me nenin 3 të ECHR-së (dhe jo thjesht duke shqyrtuar vendimin e SSHD-së për këtë çështje). Në këto rrethana, nuk është e habitshme që gjykata të jetë e gatshme të modifikojë rregullat e zakonshme të rishikimit gjyqësor për të siguruar që provat e disponueshme të jenë sa më të përditësuara që të jetë e mundur. Rasti aktual nuk ka asnjërën e këtyre veçorive. Siç e kemi theksuar, vendimi i sfiduar nuk i heq asnjë të drejtë të mëparshme Dr Berishës që të hyjë në Mbretërinë e Bashkuar, sepse ai nuk e gëzonte një të drejtë të tillë; dhe për shkak se të drejtat e ECHR-së nuk thuhet se janë të rezervuara (dhe nuk janë të rezervuara), vendimmarrësi kryesor është SSHD, jo gjykata.

Qëllimi i rishikimit për gabime materiale të faktit të provuar

- 55 Duke pasur parasysh parashtresat e bëra për ne, ne e konsiderojmë të rëndësishme të jemi të qartë në lidhje me kufizimet e gabimit material të faktit të provuar si bazë për rishikim. Ky terren i ri rishikimi, i njohur nga Gjykata e Apelit në çështjen *E*, nuk i hap rrugën SIAC (ose ndonjë gjykatë apo tribunal që zbaton parimet e rishikimit gjyqësor) për të arritur këndvështrimin e saj mbi çështjet e fakteve të diskutueshme të cilat ishin detyrë e vendimmarrësit që t'i përcaktonte. Kjo as nuk e fshin parimin e përgjithshëm se një gjykatë që zbaton parimet e rishikimit gjyqësor konsideron përshtatshmërinë e vendimit të sfiduar në bazë të materialit të paraqitur përpara vendimmarrësit. Rasti i *E*-së lejon sfidimin (kundërshtimin) vetëm kur vendimmarrësi ka bërë një gabim dhe vetëm kur të katër kushtet në [66] të gjykimit të Carnwath LJ (shih parag. 37 lart) përmbushen. Në veçanti, gabimi duhet të jetë "i provuar" në kuptimin e të qenurit "i pakontestueshëm dhe objektivisht i verifikueshëm". Arsyeimi që përfshin një gabim të tillë mund të konsiderohet si me të meta, me pasojë që kjo bazë ligjore të mund të konsiderohet si një lloj iracionaliteti: *Laë Society kundër Lord Chancellor* [2018] EëHC 2094 (Admin), [2019] 1 ËLR 1649, [98] (Leggatt LJ dhe Carr J).
- 56 Mund të ketë një debat për peshimin e hapave të mëtejshëm rreth asaj që konsiderohet si një gabim "i pakontestueshëm", për shembull në rastin kur një paditës ofron prova bindëse dhe objektive mbi një çështje me dy anë që sugjeron në anën e përparme se vendimmarrësi ka gabuar në mënyrë të pakundërshtueshme dhe vendimmarrësi nuk bën asgjë për të treguar se pika është e diskutueshme. Në këtë rast, megjithatë, çështjet për të cilat thuhet se kishin gabime ishin konkluzionet qendrore të faktit mbi të cilin u bazua vendimi. Të gjitha këto gjetje u bazuan në vlerësimet e provës, duke përfshirë atë që SSHD kishte të drejtë të supozonte se ishin përfaqësimet gjithëpërfshirëse të Dr Berishës. Kishte prova që të çonin në të dyja kahet; faktet ishin larg nga të qenurit të pakontestueshëm ose objektivisht të verifikueshëm. SSHD duhet të bënte peshimin e kësaj prove dhe të dilte në një këndvështrim. Duke parë provat e Dr Berishës pas vendimit, SSHD nuk pranon se ka pasur ndonjë gabim fakti. Ftesa drejtuar SIAC për të vendosur vetë këto çështje faktike injoron kufizimet e shqyrtimit për gabim material të faktit të provuar. Pranimi i saj do të çonte në zëvendësimin e SIAC me SSHD si vendimmarrësin kryesor mbi çështjet e fakteve kryesore që thekson vendimi, në kundërshtim me kushtet e shprehura të s. 2C(3) të Aktit të vitit 1997.

Testi që duhet aplikuar kur vlerësohet përshtatshmëria ligjore e vendimit

57 Si pasojë testi që duhet aplikuar gjatë vlerësimit të përshtatshmërisë ligjore të vendimit është nëse materiali i paraqitur para SSHD-së kur u mor vendimi i kundërshtuar (sfiduar) ka dhënë një bazë provuese të përshtatshme për përfundimet e arritura. Ne e vendosim çështjen në këtë mënyrë qëllimisht. Që prej rastit Edwards kundër Bairstow, ka qenë gjerësisht e pranuar se një vendim i arritur pa një bazë provuese do të ishte e paligjshme. Në të njëjtën mënyrë, një gjykatë që zbaton parimet e rishikimit gjyqësor mund të ndërhyjë nëse, në bazë të provave të dhëna përpara vendimmarrësit, gjetjet e bëra nuk ishin racionalisht të disponueshme për të. Kjo është një mënyrë tjetër për të thënë se do të ketë disa raste kur vendimmarrësi ka disa prova për përfundimin e arritur, por provat janë aq të dobëta dhe të parëndësishme sa që ato nuk mund të mbështesin në mënyrë racionale gjetjen e bërë. Baza e provave duhet, me fjalë të tjera, të jetë e përshtatshme. Ajo që përbën një bazë të përshtatshme provash do të jetë shumë specifike për kontekstin. Sipas këndvështrimit tonë, ky është një manifestim i shkallës lëvizëse të intensitetit të rishikimit. Prova e nevojshme për të përmbushur standardin e përshtatshmërisë mund të jetë më e rëndësishme kur vendimi që merret është ai që ndikon në të drejtat themelore. Ky vendim nuk bën pjesë në këtë kategori, edhe pse ne e pranojmë se ajo ka pasoja të rëndësishme për reputacionin e Dr Berishës.

A dha prova e paraqitura përpara SSHD-së një bazë të përshtatshme për vendimin e përjashtimit?

58 Nëse materialet e paraqitura para SSHD-së do të ishin limituar në artikuj me burim të hapur nga gazetatat dhe faqet e internetit, ne dyshojmë se ato vetë do të mund të kishin ofruar një bazë të përshtatshme për konkluzionet specifike mbi të cilat u bazua vendimi për përjashtim. Por materialet që ne kemi parë përfshijnë edhe vlerësime të kujdesshme përsa i përket besueshmërisë së gazetave dhe faqeve të internetit, të bëra këto nga persona me njohuri dhe përvojë specifike të kushteve në Shqipëri. Mbështetja jonë në konkluzionet e Departamentit të Shtetit të SHBA-së ishte gjithashtu, sipas këndvështrimit tonë, i justifikuar. Konkluzionet e raportuara në këto dokumente janë një produkt i konsideruar institucional i një administrate që zotëron burimet më të mira të çdo shteti miqësor.

59 Së fundi, dhe më e rëndësishmja, vendimet u bazuan në një sasi të madhe informacioni të burimit të brendshëm në formën e telegrameve diplomatike, të cilat janë komunikime diplomatike nga ambasada në Tiranë tek FCDO në Londër . Këto vlerësime nuk janë përgatitur për qëllime procedimi, apo për të informuar vendimet e përjashtimit; përkundrazi, ata janë përgatitur në kohë reale dhe komunikuar për t'i dhënë Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar një pasqyrë sa më të saktë të mundshme të kushteve në një shtet të caktuar. Ato reflektojnë jo vetëm raportimin me burim të hapur, por edhe burime të tjera informacioni në dispozicion të diplomatëve që operojnë në vend. Marrja në konsideratë e një sërë raportesh të tilla me kalimin e kohës mund, sipas këndvështrimit tonë, të sigurojë një burim provues të mjaftueshëm të informacionit me qëllim marrjen e vendimeve të përjashtimit.

60 Dokumentet e paraqitura para SSHD kur u mor vendimi i datës 27 shkurt 2023 duket se na tregojnë një angazhim të kujdesshëm në përfaqësimet e Dr. Berishës; dhe se rekomandimet e CSNP-së u vlerësuan në mënyrë kritike nga zyrtarët e SSHD-së (shih p.sh pranimi i këndvështrimit të Dr. Berishës se afërsia e tij me Dautin në video nuk tregonte domosdoshmërisht një lidhje personale ndërmjet të dyve). Nëse dhe në masën që parashtrësia e Dr. Berishës të kuptohen siç duhet si dhe që na ftojnë ne të aplikojmë llojet e standardeve të provave që do të kërkoheshin nëse akuzat kundër tij do të ishin të bëra në kuadrin e një gjykimi penal, ose në të vërtetë në një proces civil, ne i refuzojmë këto parashtrësia.

- 61 Sipas këndvështrimit tonë, secili prej përfundimeve të përcaktuara në parag. 11 më sipër ishte plotësisht i hapur për SSHD-në në bazë të materialeve të paraqitura para vendimmarrësit kur vendimi u mor. Në çdo rast, përfundimi ishte produkt i një vlerësimi holistik të provës së disponueshme, duke përfshirë raportimin me burim të hapur dhe të brendshëm dhe përfaqësimet e Dr Berishës. Ne nuk identifikuan asnjë aspekt në të cilin provat të ishin të pamjaftueshme për të bazuar daljen në këtë konkluzion.
- 62 Përsa i përket çështjeve të përcaktuara në Arsyetimet e Ndryshuara (në parag. 12), ne konkludojmë si më poshtë:
- (a) Raporti i brendshëm dhe raporti i Departamentit të Shtetit të SHBA-së ofroi një bazë provuese të mjaftueshme për arritjen në përfundimin se Dr. Berisha e kishte mbrojtur Fazllicin nga ndjekja penale.
 - (b) Videoja ku shihet Dauti duke shkelmuar derën e selisë së Partisë Demokratike dhe një grup në të cilin bënte pjesë Dr. Berisha duke hyrë u përdor plotësisht për të vërtetuar prova të tjera, të pasqyruara në telegramët diplomatikë, se Dr Berisha përdor lidhjet kriminale për përfitime të tij personale.
 - (c) Ne jemi të kënaqur në bazë të provave që kemi në dispozicion me anë të burimeve të MBYLLURA se komunikimet diplomatike të disponueshme për SSHD-në siguruan një procesverbal të saktë vëzhgimesh dhe pikëpamjesh nga Ambasada në Tiranë për çështje që lidhen me këtë vendim dhe mund të mbështeteshim plotësisht për arsyet që kemi theksuar.
 - (d) Ndryshimi i formulimit midis vendimit të parë dhe të dytë (nga ku shprehet fillimisht se kjo “shfaqte” Dr Berishën duke organizuar dhe marrë pjesë në një protestë të dhunshme ku përfshiheshin kriminelë të njohur për të “pretenduar/dyshuar” të njëjtën gjë) nuk na u duk se ishte e rëndësishme. Në çdo rast, ne jemi të kënaqur që përfundimi i limituar që u mor si pasojë e videos ishte vendimi i duhur bazuar në provën e dhënë.
 - (e) Fakti që Dr. Berisha kishte qenë përgjegjës për nxjerrjen e disa masave antikorrupsion nuk i dobëson konkluzionet e SSHD-së se ai kishte përfituar gjithashtu nga lidhjet me grupe të organizuara kriminale.
 - (f) Pranimi se akuzat për korrupsion ndaj vajzës së Dr. Berishës nuk ishin një aspekt kyç i rekomandimit që çoi në përjashtimin e Dr. Berishës përforcoi më tepër sesa dobësoi përfundimin tonë se vendimi kishte një bazë të duhur provues.
 - (g) Pyetja që ne kemi është nëse të gjitha burimet e informacionit, të marra së bashku, ofruan një bazë të duhur provuese për lidhjet që SSHD gjeti se ekzistojnë midis Dr Berishës dhe grupeve të organizuara kriminale. Përgjigja është "Po".
- 63 Arsyetimi 1 në këtë mënyrë rrëzohet.

Arsyetimi 2

Parashtresat për Dr Berishën

64 Z. Randolph parashtroi se materiali i disponueshëm që sugjeronte korrupsion ose lidhje kriminale nga ana e Dr Berishës nuk ishte më i madh sesa ai në dispozicion në lidhje me politikanë të tjerë shqiptarë, duke përfshirë në veçanti Edi Ramën, kryeministrin aktual dhe njëkohësisht rivalin politik të opozitës së Dr Berishës. Kjo, tha ai, nënkuptonte se të dy vendimet për të hetuar Dr Berishën dhe konsideruar këtë të fundit për përjashtim dhe vendimin pas këtij hetimi për të përjashtuar Dr Berishën ishin të paarsyeshme sepse bazoheshin në një dallim arbitrar, duke ndjekur arsyetimin e *Bankës Mellat dhe A kundër SSHD*. Për më tepër, nuk kishte bazë për të menduar se qëllimet e CSNP-së nuk do të përmbusheshin më mirë duke proceduar kundër zotit Rama, i cili në fund të fundit ishte në pushtet. Së fundi, SSHD nuk ka dhënë asnjë arsye për të veçuar Dr Berishën dhe për të mos proceduar kundër të tjerëve në një pozicion analog.

Parashtresat për SSHD

65 Znj. Giovannetti parashtroi se rasti në fjalë ishte i ndryshëm nga Banka Mellat dhe A kundër SSHD. Në Bankën Mellat, Gjykata e Lartë procedoi mbi bazën se problemi për të cilin masa ishte projektuar që të adresonte ishte një problem i përbashkët për të dhe gjithashtu një numër i vogël i bankave të tjera iraniane, të cilat nuk ishin shënjestruar. Këtu, SIAC nuk mund të procedonte mbi bazën se korrupsioni është një problem që prek në mënyrë të barabartë të gjithë politikanët shqiptarë. Nuk ka asnjë parim të së drejtës publike që kërkon që SSHD të kryejë një vlerësim të individualizuar të të gjithë politikanëve shqiptarëve përpara se të vazhdojë me dhënien e vendimit për përjashtimin e njërit prej tyre. Në secilin rast, si çështje praktike, SSHD-së i duhej t'ia niste nga diku. Procesi kishte si qëllim përzgjedhjen e një grupi fillestar për hetim (që çonin në vendime për përjashtim). Ky proces nuk do të përfshinte vendime ku asnjë tjetër nuk do të përjashtohet.

Diskutim

Legjislacioni

66 Gjykata e Lartë e ka bërë të qartë se parimi i trajtimit të barabartë ose mosdiskriminimi (i cili ka një ekzistencë të pavarur në të drejtën e BE-së dhe në disa sisteme të tjera ligjore) është në legjislacionin anglez thjesht një aspekt i doktrinës së racionalitetit: shih *R (Gallaher Group Ltd) kundër Autoritetit të Konkurrencës dhe Tregjeve* [2018] UKSC 25, [2019] AC 96, [24]- [26]. Një vendim për të ndërmarrë veprime kundër personit X mund, në disa rrethana, të duket irracionale duke iu referuar faktit se nuk u ndërmor asnjë veprim kundër personit Y, por një pjesë e mirë e tij do të varet nga konteksti.

67 Konteksti i vendimeve të sfiduara në *Bankën Mellat*, bazuar në analizën e Gjykatës së Lartë, kishte një sërë veçorish të veçanta. Në veçanti, vendimmarrësi po kërkonte që të arrinte qëllimin për të kufizuar aksesin e qeverisë iraniane në tregjet ndërkombëtare financiare. Kishte një numër të vogël bankash iraniane me një prani ndërkombëtare përmes së cilës banka mund ta fitonte këtë akses. Gjykata e Lartë arriti në përfundimin se nuk kishte asgjë që e dallonte Bankën Mellat në thelb si më me shumë gjasa për të lehtësuar këtë akses se bankat e tjera. Kjo e bëri vendimin për të veçuar Bankën Mellat (duke mos ndërmarrë ndërkohë veprime kundër bankave të tjera) arbitrar dhe irracionale, jo më pak për shkak se Qeveria iraniane do të ishte ende në gjendje të kishte akses në tregjet financiare përmes bankave të tjera.

Nuk ka asnjë sugjerim se nuk do të kishte qenë praktikisht e mundur vendosja e kufizimeve financiare në të gjithë numrin e vogël të bankave ndërkombëtare iraniane.

- 68 Konteksti i vendimit aktual është në thelb i ndryshëm në tre aspekte kryesore. Së pari, qëllimi i trajtimit të korrupsionit në Ballkanin Perëndimor dhe në Shqipëri në veçanti mund, si çështje logjike, të paraqitet në mënyrë të përshtatshme duke proceduar kundër disa (jo të gjithë) politikanëve të korruptuar. Së dyti, natyra e qëllimit (frenimi i korrupsionit në të ardhmen) nënkupton domosdoshmërisht se do të duhej t'i jepej konsideratë individuale provave për secilin kandidat të mundshëm për përjashtim. Së treti, nuk do të kishte qenë praktikisht e mundur të jepej një konsideratë e tillë individuale për çdo politikan shqiptar; detyra do të kishte qenë e pamënaxhueshme.
- 69 Racionaliteti i vendimit për përjashtimin e Dr. Berishës duhet, sipas këndvështrimit tonë, të konsiderohet në faza. Së pari, ishte vendimi për përzgjedhjen e një numri kandidatësh për përjashtim në një “grup të parë”. Vendimi për të vazhduar në këtë mënyrë duket të jetë krejtësisht racional për ne. Në të vërtetë, e kemi të vështirë të kuptojmë se si mund të kishte vazhduar SSHD ndryshe. Siç e kemi thënë, dhe ndryshe nga *Banka Mellat*, nuk do të ishte praktike kryerja e një hetimi për çdo politikan shqiptar ndaj të cilit janë ngritur akuza për korrupsion, apo edhe ndaj çdo figure të shquar. Një rrjedhë e tillë do të kishte sjellë një shpërndarje jo proporcionale të burimeve të kufizuara të SSHD-së. Dhe, sërish, ndryshe nga *Banka Mellat*, vendimi për të filluar me një grup fillestar nuk do bësoi qëllimet e CSNP-së, për të penguar korrupsionin në të ardhmen. Ky qëllim do të përparonte duke ia bërë të qartë kujtdo që merr në konsideratë përfshirjen e tij/saj në korrupsion në të ardhmen se ai ose ajo mund të jetë subjekt përjashtimi.
- 70 Më pas, ishte vendimi se si do të përzgjidheshin kandidatët për t'u përfshirë në grupin fillestar. Ne mund të shprehemi pak më shumë mbi këtë në burimin e MBYLLUR. Ajo që mund të thuhet në burimin e HAPUR, megjithatë, është se grupi i parë i individëve të përzgjedhur për hetim dhe së fundmi përjashtimi synonte të ishte - dhe është në fakt- i ekuilibruar politikisht. Kështu për ne duket se është një racional desideratum (“dëshirë/nevojë e arsyeshme”).
- 71 Së fundmi, nuk është marrë asnjë vendim që SSHD nuk do të vazhdojë të hetojë dhe të përjashtojë dikë tjetër. Mbetet e mundur që të tjerë të hetohen dhe të përjashtohen në të ardhmen. Kjo për ne duket të jetë një veçori e rëndësishme në shqyrtimin nëse vendimi për të proceduar kundër Dr Berishës, dhe jo të tjerëve, ishte arbitrar.
- 72 Për këto arsye, konkludojmë se nuk ka pasur arbitraritet apo irracionalitet të këtij lloji të dyshuar në procesin e vendimmarrjes që çoi në përjashtimin e Dr. Berishës. Ne shtojmë se po të kishte ekzistuar një gjë e tillë, është qartazi e dukshme se do të na ishte kërkuar që të lejonim kërkesën për shqyrtim të Dr Berishës. Nëse, në kundërshtim me përfundimet tona, SSHD do të kishte vepruar në mënyrë të paarsyeshme duke mos proceduar kundër të tjerëve, një pasojë e mundshme mund të ishte se racionaliteti i kërkonte atij që të vepronte kundër të tjerëve, në vend që ta zhvlerësonte këtë vendim për të proceduar kundër Dr Berishës.

Arsyetimi 4

Parashtrësit për Dr Berishën

- 73 Z. Randolph parashtrëtoi se SSHD nuk mori parasysh faktin se shënjestrimi i dikujt që nuk kishte qenë në pushtet për 10 vite, dhe anashkalimi i personit aktualisht

në pushtet (Zotin Rama) do të sillte forcimin e sponsorizuesve të grupeve të krimit të organizuar, të cilët kanë një pushtet real dhe aktual.

Parashtrësats për SSHD

- 74 Znj. Giovannetti parashtrroi se ky arsyetim ishte keqkuptuar. Premisa e saj ishte se përjashtimi i Dr. Berishës do të ishte i paefektshëm. Në fakt, SSHD shqyrtoi me kujdes nëse përjashtimi i grupit të parë të kandidatëve do të ishte efektiv dhe konkludoi se po. Vendimi bazohej, ndër të tjera, në konsiderata të politikave të huaja mbi të cilën SSHD gëzon të drejtën e një zone të gjerë diskrete gjykimi.

Diskutim

- 75 Siç kemi referuar, ne mund të shprehemi pak më shumë në burimin e MBYLLUR për bazën mbi të cilën u zgjodh grupi fillestar i kandidatëve. Shqyrtimi ynë i tërësisë së provave, me burim TË HAPUR dhe TË MBYLLUR, na bind se kriteret e përzgjedhjes i është kushtuar kujdes i hollësishëm. Ne nuk kemi vërejtur asgjë që të tregonte se ndonjëri nga kriteret ishte irracional ose anasjelltas i paligjshëm. Vlerësimi nëse përjashtimi i tyre në grupin fillestar (dhe jo i të tjerëve) do të ishte efektiv në frenimin e korrupsionit në të ardhmen u mor parasysh për të gjithë faktorët përkatës. Ne e pranojmë parashtrësën e SSHD-së se ky lloj vlerësimi është një vlerësim për të cilën ata që japin këshilla për SSHD-në kanë kompetenca të veçanta institucionale dhe për të cilën ne duhet të ecim me hapa të ngadaltë për të ndërhyrë: shih p.sh. *R (Carlile) kundër SSHD* [2014] UKSC 60, [2015] AC 945.

Arsyëtimi 5

Parashtrësats për Dr Berishën

- 76 Z. Randolph parashtrroi se SSHD mori parasysh shqyrtime të parëndësishme. Në veçanti, se çdo vepër e kryer gjatë kohës që Dr Berisha ishte President ose Kryeministër i Shqipërisë mbrohej nga imuniteti i sovranitetit dhe nga pasojat negative të reputacionit që do të shkaktehej me tërheqjen e përjashtimit të Dr. Berishës. Përveç kësaj, vendimmarrësi mori parasysh katër çështje faktike të cilave u mungonte baza e duhur e themelit provues dhe, edhe nëse kjo do të ishte e vërtetë, nuk do të mund të provonte se Dr. Berisha përbën rrezik për MB, përkatësisht: (i) rënia e skemave piramidale në vitin 1997; (ii) pretendimin se një park energjetik u zgjerua për të pasuruar z. Fazllic; (iii) pretendimet e Zafar Ansar se në vitin 2008 zonja Malltezi u përpoq ta shantazhonte duke përdorur marrëdhënien e saj me Dr Berishën; dhe (iv) pretendimin se Dr. Berisha nxiti Fation Dautin të angazhohej në sjellje të dhunshme (shkëmbimin e derës së selisë së Partisë Demokratike në emër të Dr Berishës)
- 77 Z. Randolph pranoi se, për aq kohë sa ai mbulohej nga imuniteti i sovranitetit, ky arsyetim u mbivendos në arsyetimin 6. Nëse kjo e fundit do të rezultonte e suksesshme, do të ishte e panevojshme të shtohej se vendimmarrësi ishte mbështetur në çështje që ishin të parëndësishme për këtë arsye. Nëse jo, premisa për pretendimin se aktet e nxjerra si President ose Kryeministër ishin të parëndësishme do të rrëzoheshin.

Parashtrësats për SSHD

- 78 Znj. Giovannetti parashtrroi se premisa për sugjerimin se SSHD kishte marrë parasysh dëmin e reputacionit që do të shkaktehej nga tërheqja e vendimit ishte një fragment në Aneksin G tek parashtrësja ministrore e datës 21 shkurt 2023. Në një inspektim

të mbyllur, ky fragment nuk tregoi se pasojat e parashikuara të reputacionit ishin pjesë e arsyeve të vendimit. Përsa i përket çështjeve faktike të identifikuara, nuk kishte një bazë të vlefshme për të konkluduar se ndonjë prej tyre ishte i parëndësishëm.

Diskutim

- 79 Ne e kemi shqyrtuar me kujdes fragmentin e mbështetur për të treguar se vendimmarrësi ka marrë parasysh pasojat e reputacionit për tërheqjen e vendimit. Ne nuk konsiderojmë se fragmenti tregon se konsiderata të tilla janë marrë parasysh si pjesë e arsyeve për vendimin. Parashtrësia ministrore e drejtoi SSHD-në të “merre parasysh informacionin në Aneksin D... si pjesë e procesit të vendimmarrjes”. Pasojat e mundshme reputacionale të tërheqjes së vendimit nuk ishin në Aneksin D, por në Aneksin G, me titull “Pikëpamjet e palëve të interesuara”. Kjo raportoi këndvështrimin e Ambasadës Britanike në Tiranë se përjashtimet nuk kishin prekur në mënyrë të dëmshme marrëdhëniet e Mbretërisë së Bashkuar me Shqipërinë (parag. I) dhe u shprehën duke thënë se suksesi i apelimit të Dr Berishës do ta dëmtonte atë nga ana reputacionale (parag. 4) dhe se tërheqja e vendimit para një apelimi do të çonte në një dëm më të madh reputacioni (parag. 5).
- 80 E parë në kontekst, fragmenti ku u mbështet ky vendim nuk tregon se dëmi i mundshëm i reputacionit ishte pjesë e “arsyeve për vendimin”. Siç SSHD parashtrë, nëse vendimet e përjashtimit do të kishin shkaktuar në vetvete një ndikim negativ në marrëdhëniet MB - Shqipëri kjo mund të kishte qenë një arsye për t'i anuluar ato. Duke qenë se kjo nuk ka ndodhur, parashtrësia ministrore u hartua me kujdes për të kufizuar arsyet e vendimit në ato të aneksit D. Ne gjykojmë se mund të konkludojmë me të drejtë se SSHD nuk e kishte marrë parasysh pikëpamjen e Ambasadës Britanike rreth dëmtimit të mundshëm të reputacionit në rast revokimi të vendimeve të përjashtimit si pjesë e këtyre arsyeve.
- 81 Edhe nëse ne do ta kishim gabim në lidhje me të, ne nuk gjykojmë se një referencë e tillë për risqet e reputacionit do të zhvlerësonte vendimin në kontekstin e një parashtrimit ku pika kryesore e të cilit ishte të theksonte se ekzistonte rasti i duhur faktik dhe juridik për përjashtim. Pozicioni mund të kishte qenë i ndryshëm nëse SSHD do të ishte këshilluar se baza faktike dhe ajo ligjore për përjashtim ishte e dobët, por revokimi i vendimeve të mëparshme do të ishte problematik nga ana reputacionale. Por kjo nuk është ajo çfarë ndodhi.
- 82 Për sa i përket çështjeve faktike që thuhet se përbëjnë gjykime të parëndësishme, konkluzionet tona mbivendosen me konkluzionet në lidhje me arsyetimin 1. Duke trajtuar çështjet e identifikuara me radhë:
- (a) Mbi tërësinë e provave, përfshirë raportimin e brendshëm, ka pasur një bazë provuese të mjaftueshme për të dalë në përfundimin se Dr. Berisha ishte fajtor dhe i implikuar në skemat mashtruese piramidale të cilat ranë duke shkaktuar një skandal kombëtar në kohën kur ai ishte President.
 - (b) Konkluzioni se Dr Berisha ka kryer shkelje në lidhje me parkun energjetik bazohej në përfundime që kishin një bazë të mjaftueshme provuese.
 - (c) Dyshimi se vajza e Dr Berishës kishte përfituar nga investimi prej 100 milion dollarësh i Zafar Ansarit për një termocentral u vlerësua me kujdes, së bashku me mohimin e bërë nga ana e zj. Malltezi. Përfundimi se mund të mbështeteshim ende në dyshimin fillestar kishte një bazë të mjaftueshme provuese.

- (d) Lidhja me Dautin, e mbështetur në parashtrësën ministrore, nuk ishte për faktin se Dr Berisha e njihte personalisht atë, por përkundrazi se videoja tregoi se Dr Berisha ishte i gatshëm të përdorte lidhjet kriminale për përfitime të tij. Ky ishte një përfundim me burim të hapur përse i përket provës. Lidhja me Dautin pra nuk ishte një argument i parëndësishëm.

Arsyetimi 6

Parashtrësat për Dr Berishën

- 83 Parashtrësat e z. Randolph për arsyetimin 6 u prezantuan përgjatë seancës dëgjimore. Me ftesën tonë, ai i reduktoi këto parashtrësa me një shënim të depozituar më datë 22 mars 2024, pas seancës dëgjimore.
- 84 Z. Randolph parashtrëtoi se doktrina e imunitetit të shtetit funksionon si një normë ndërkombëtare e cila ruan barazinë sovrane ndërmjet shteteve. Si kreu i shtetit ashtu edhe kreu i qeverisë përfitojnë nga imuniteti *ratione personae* (“nga natyra e personit”) për sa kohë që ata mbajnë këto poste dhe nuk aplikohet asnjë përjashtim përkatës; asnjë nuk aplikohet këtu. Pas largimit nga detyra, ata vazhdojnë të kenë imunitet *ratione materiae* (“nga natyra e materies”) në lidhje me aktet e nxjerra gjatë kohës që kanë qenë në detyrë. Ky imunitet është kompleks dhe i nënshtrohet kushteve specifike; përsëri, megjithatë, asnjë nga këto kushte specifike nuk aplikohet këtu.
- 85 Z. Randolph vëren se, sipas politikës së vetë SSHD-së, gjetjet e korrupsionit duhet të kenë të bëjnë me sjellje që do të ishin në kundërshtim me ligjin penal të Mbretërisë së Bashkuar. Por SSHD ka pranuar se nuk do të mund të ngrihet asnjë ndjekje penale kundër Dr. Berishës në lidhje me aktet e nxjerra prej tij gjatë kohës që ai ishte në detyrë si President apo Kryeministër. Prandaj, aktet përkatëse duhet të përjashtohen nga shqyrtimi nën politikën e SSHD-së.
- 86 Mbretëria e Bashkuar ka sigurisht të drejtë të refuzojë hyrjen në territorin e saj të krerëve të shteteve dhe krerëve të qeverive të shteteve të huaja. Kjo rrjedh nga e drejta sovrane e Mbretërisë së Bashkuar për të kontrolluar kufijtë e saj, por kjo nuk do të thotë se një kryetar aktual apo ish kreu i shtetit nuk ka imunitet në lidhje me procedimet e inicuar nga SSHD, të bazuara në gjetjet e kriminalitetit ose korrupsionit, të cilat çojnë në vendim përjashtimi. Në një situatë të tillë, individi i përjashtuar ndodhet në pozicionin e një personi të dënuar de facto për këto vepra. Këto gjetje mund të përdoren nga shteti i origjinës së Dr Berishës - Shqipëria - për të ndjekur penalisht Dr Berishën. Në këtë drejtim, është për të theksuar se Dr Berisha është aktualisht në arrest shtëpie dhe nuk mund të largohet nga Shqipëria.
- 87 Z. Randolph u mbështet në gjykimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë në *Çështjen e Lidhur me Urdhër Arrestin e datës 11 Prill 2000 (Republika Demokratike e Kongos kundër Belgjikës)*, Raportet ICJ 2002, paragraf. 61 si autoritet për propozimin se një ish kryetar shteti apo kreu i Qeverisë vazhdon të gëzojë imunitet kundrejt ndjekjes penale në një shtet tjetër në lidhje me aktet e nxjerra si kreu i shtetit ose kreu i qeverisë. Shih gjithashtu paragrafët 83-85 në Opinionin e Përbashkët Vetjak të Gjyqtarëve Higgins, Kooijmans dhe Buergenthal.

- 88 Znj Giovannetti gjithashtu me ftesë tonën plotësoi parashtresat e saj me një shënim të datës 21 mars 2024, depozituar pas përfundimit të seancës dëgjimore. Ajo parashtroi se parimi i imuniteti shtetëror “lehtëson kryerjen e funksioneve publike të shtetit dhe zyrtarëve të tij duke i penguar ata të paditen apo të ndiqen penalisht në gjykatat e huaja”: shih Parimet e së Drejtës Ndërkombëtare të Brownlie (bot. i 9-të., 2019), fq. 470. Nuk ka tensionim midis kësaj të drejte dhe të drejtës sovrane të mirënjohur të shteteve për të kontrolluar hyrjen dhe qëndrimin e shtetasve të huaj në territorin e tyre. Kështu, “edhe pse krerët e shteteve gëzojnë privilegje dhe imunitete të gjera, ata nuk kanë të drejtë të hyjnë në një shtet të huaj pa pëlqim, të nënkuptuar ose anasjelltas, të atij shteti”: Foakes, *Pozicioni i Krerëve të Shtetit dhe Zyrtarëve të Lartë në Ligjin Ndërkombëtar* (2014), fq. 17.
- 89 Foakes jep shembuj të shteteve që ushtrojnë të drejtën e tyre sovrane për të përjashtuar krerët e shteteve të huaja, në veçanti vendimet e SHBA -së për të ndaluar hyrjen e Presidentit Waldheim të Austrisë në vitin 1987-ës, të Francës për të ndaluar Presidentin Mobutu të Zaires në vitin 1993 dhe të Sllovakisë për të ndaluar Presidentin e Hungarisë në vitin 2012. Siç u theksua prej saj, vendimi i fundit u kundërshtua para Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, e cila u shpreh se e drejta e sovranit për të përjashtuar krerët e shteteve nga territori i tij ishte i paprekur nga dispozitat e lëvizjes së lirë të Traktateve të BE-së: Shih Rastin e C-364/10 *Hungaria kundër Sllovakisë* [2013] 1 CMLR 21, në [45]-[52].
- 90 Imuniteti shtetëror është pasqyrimi i parimit të barazisë sovrane të shteteve, i cili është ndonjëherë i përmbledhur në parimin që një pushtet sovran nuk mund të ushtrojë juridiksion mbi një pushtet tjetër sovran: Denza, *E Drejta Diplomatike* (bot. i 4-tërt , 2016), fq. 235. Ish-krerët e shteteve dhe krerët e qeverisë gëzojnë imunitet *ratione materiae* (“për shkak të natyrës së posteve përkatëse të mbajtura”) nga juridiksioni penal dhe civil i shteteve të tjera, por kjo nuk cenon në asnjë mënyrë të drejtën e këtyre shteteve për të kontrolluar hyrjen në territorin e tyre.

Diskutim

- 91 Sipas këndvështrimit tonë, kjo bazë ankimi bazohet në një keqkuptim themelor përsa i përket karakterizimit ligjor të vendimit të sfiduar. Siç kemi thënë në paragrafët 18-23 më lart, Dr. Berisha nuk ka gëzuar asnjëherë asnjë të drejtë për të hyrë në MB, qoftë si çështje të së drejtës së brendshme kombëtare apo si çështje të së drejtës ndërkombëtare. Kështu ishte edhe kur ai shërbente si kreu i shtetit dhe kreu i qeverisë dhe, me arsye edhe më të fortë, pasi u largua nga këto poste. Si çështje e së drejtës ndërkombëtare, vendimi nëse MB do ta pranojë Dr Berishën në territorin e saj është një ushtrim i të drejtës sovrane të MB-së për të kontrolluar hyrjen në territorin e saj: shih Foakes, në veprën e cituar. Sipas këndvështrimit tonë, vendimi për përjashtimin e Dr. Berishës ishte gjithashtu, në terma të së drejtës ndërkombëtare, një ushtrim ekuivalent i së drejtës sovrane të MB-së për të kontrolluar hyrjen në territorin e saj, megjithëse MB kërkon aplikim për të lejuar hyrjen brenda territorit të saj.
- 92 Parashtresa e zotit Randolph se një vendim i marrë në bazë të gjërave të bëra nga Dr Berisha si kreu i shtetit ose kreu i qeverisë cenon imunitetin *ratione materiae* (“për shkak të natyrës së posteve përkatëse të mbajtura”) që Dr. Berisha gëzon si ish mbajtës i këtyre posteve, do të kishte rezultate befasese, nëse kjo do të ishte i saktë. Siç e theksuam gjatë rrjedhës së argumentimit, kjo do të thoshte (për shembull) se, nëse kreu i mëparshëm i një shteti armiqësor do të dëshironte të vinte në MB, MB do të ishte e detyruar, kur të vendoste nëse do ta pranonte atë, të injoronte çdo gjë që ai kishte bërë si kreu i atij shteti, sado të dëmshme të ishin këto për interesat e Britanisë së Madhe. Por, siç shpjegon Prof. Foakes,

një shtet nuk është i detyruar të pranojë as kreun e një shteti dhe as kreun e tij të qeverisë në detyrë. Shembujt që ajo jep përfshijnë rastet kur vendimi për refuzimin e hyrjes është marrë qartazi në bazë të akteve të kryera nga kreu i Shtetit në këtë kapacitet. Duke qenë kështu do të ishte anormale nëse e drejta ndërkombëtare do të ndikonte në gjykimet që një shtet mund të marrë parasysh kur vendos nëse do të pranonte një shtetas të huaj që dikur mbante, por tashmë nuk i mban më këto poste.

- 93 Sipas këndvështrimit tonë, gabimi themelor në parashtrësën e z. Randolph është se e trajton vendimin e SSHD-së për të përjashtuar Dr. Berishën bazuar pjesërisht në sjelljen e tij si President dhe Kryeministër, si të ngjashëm me të qenurit subjekt i një procedimi penal ose civil në lidhje me këtë sjellje. Është e mirëprovuar se, duke qenë subjekt i përjashtimeve të kufizuara (shih *R kundër Bow Street Metropolitan Stipendiary Magistrate ex p. Pinochet Ugarte* (Nr. 3) [2000] 1 AC 147), shtetet nuk mund t'i bëjnë subjekt të procedimeve penale ish krerët e shteteve ose qeverive të huaja në gjykatat e tyre në lidhje me aktet e kryera si kreu i shtetit ose i qeverisë. Ndalohet gjithashtu imponimi i përgjegjësisë civile për akte të tilla, me përjashtime. Por kjo ndodh sepse në të dyja rastet procedimi shtetëror përbën një ushtrim juridiksioni mbi shtetin tjetër, në shkelje të parimit *in parem non habet imperium* (“të barabartët nuk kanë sovranitet mbi njëri-tjetrin”). Përjashtimi i dikujt që nuk është shtetas ose rezident nga territori i një shteti nuk është një ushtrim juridiksioni në ndonjë kuptim të ngjashëm, sepse kjo nuk përfshin ndonjë ndërhyrje ose ndryshim të të drejtave ekzistuese.
- 94 Vendimi për përjashtim ka shkaktuar, sigurisht, procedime ligjore pranë SIAC (Komisionit të Posaçëm të Apelit për Imigracionin), por këto procedime janë ngritur nga vetë Dr. Berisha. Ishte ai që vendosi pozitivisht të ftonte SIAC të prononcohej për ligjshmërinë e vendimit të përjashtimit. Procedimi, sipas këndvështrimit tonë, nuk përfshin asnjë ushtrim “juridiksioni” mbi të, në kuptimin me të cilin ky term është përdorur në të drejtën ndërkombëtare.
- 95 Rrjedhimisht, sipas këndvështrimit tonë, as doktrina e imunitetit të shtetit, as çdo imunitet (në masën që është i njohur) që Dr. Berisha mund të gëzojë *ratione materiae* (“për shkak të natyrës së posteve përkatëse të mbajtura”) në lidhje me veprime të kryera si kreu i shtetit apo kreu i qeverisë, nuk gjen asnjë zbatim në këtë apelim. Ne duhet të regjistrojmë gjithashtu se nuk ka pasur asnjë sugjerim, qoftë nga vetë Dr. Berisha apo nga Qeveria e Shqipërisë (e cila është në dijeni të procedimit), se në këtë apel është implikuar doktrina e aktit të huaj të Shtetit.

Konkluzion

- 96 Për këto arsye dhe arsye të tjera të përfshira në gjykimin tonë TË MBYLLUR, kërkesa për rishikim të vendimit të SSHD-së (Sekretarit të Shtetit për Departamentin e Brendshëm) për përjashtimin e Dr Berishës nga Mbretëria e Bashkuar hidhet poshtë.